

REPUBLIKA E SHQIPERISE
Keshilli i Ministrave

VENDIM

Nr. 320, date 19.3.2008

PER SISTEMIN E IDENTIFIKIMIT TE KAFSHEVE DHE TE REGJISTRIMIT TE FERMAVE BLEGTORALE

Ne mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenëve 3, pikat 6, 7, 38 e 39, 24, shkronja "b", e 32, pika 6, të ligjit nr.9308, datë 4.11.2004, "Për shërbimin dhe Inspektoratin Veterinar", dhe të nenit 4, të ligjit nr.8702, datë 1.12.2000, "Për identifikimin e kafsheve dhe regjistrimin e fermave blegtorale", me propozimin e ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Keshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Autoriteti përgjegjës për regjistrin kombëtar të identifikimit të kafsheve dhe të regjistrimit të fermave blegtorale është drejtoria, që mbulon fushën e veterinarisë, në Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit 1.

Detyrat dhe përgjegjësitë e këtij autoriteti përcaktohen me udhëzim të ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

2. Për qëllimet e këtij vendimi, termat e mëposhtme kanë kete kuptim:

1" Fond kunderparti", fondi i krijuar nga pagesat e fermereve, për bazën materiale të sistemit të identifikimit të kafsheve, dhe që përdoret për blerjen, në vazhdimësi, të materialeve, për funksionimin e këtij sistemi.

"Operator privat", personi i kontraktuar nga sektori veterinar i drejtorisë rajonale të bujqësisë, ushqimit dhe mbrojtjes së konsumatorit, për zbatimin në terren të sistemit të identifikimit të kafsheve.

3. Drejtoritë rajonale të bujqësisë, ushqimit dhe mbrojtjes së konsumatorit (sektori veterinar) drejtojnë dhe zbatojnë, për çdo zonë që mbulojnë, sistemin e identifikimit të kafsheve dhe të regjistrimit të fermave blegtorale, nëpërmjet specialistëve private, veterinarë dhe zooteknike, me të cilët lidhin kontratat përkatëse.

4. Kostoja financiare e sistemit të identifikimit të kafsheve dhe të regjistrimit të fermave blegtorale, për pagesën e bazës materiale dhe për shërbimin e kryer nga operatorët private mbulohet nga buxheti i këtij viti, miratuar për kete qëllim, për Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

5. Pagesa për operatorët private bëhet nga buxheti i matrikulimit, i planifikuar nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, për vitin 2008, për drejtoritë rajonale të bujqësisë, ushqimit dhe mbrojtjes së konsumatorit, në qarqe, si më poshtë vijon:

a) Për gjedhin, 90 (nëntëdhjetë) leke, për çdo kafshë të matrikuluar.

b) Për bagetite e imta, 20 (njëzet) leke, për çdo kafshë të matrikuluar me matrikul individuale, dhe 5 (pese) leke për krere, për matrikulimin e kafsheve të reja, me destinacion për therje.

Ne sherbimin e kryer nga operatori privat perfshihen matrikulimi i kafshes dhe plotesimi e dorezimi i formulareve respektive ne drejtorite rajonale te bujqesise, ushqimit dhe mbrojtjes se konsumatorit, ku jane te kontraktuar.

6. Fondi kunderparti, i krijuar deri ne fund te vitit 2007, "Per sistemin e identifikimit te kafsheve dhe te regjistrimit te fermave blegtorale", te perdoret per blerjen, ne vazhdimesi, te material eve per sistemin e identifikimit te kafsheve dhe per regjistrimin e fermave blegtorale, sipas udhezimit perkates te ministrit te Bujqesise, Ushqimit dhe Mbrojtjes se Konsumatori t.

7. Organet e qeverisjes vendore, Policia e Shtetit dhe Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujerave bashkepunojne dhe mbeshtetin drejtorite rajonale te bujqesise, ushqimit dhe mbrojtjes se konsumatorit per zbatimin e sistemit te identifikimit te kafsheve dhe te regjistrimit te fermave blegtorale dhe per kontrollin e levizjes se kafsheve, sipas udhezimit perkates, te ketyre institucioneve.

8. Ngarkohen Ministria e Bujqesise, Ushqimit dhe Mbrojtjes se Konsumatorit, Ministria e Brendshme dhe Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujerave per zbatimin e ketij vendimi.

9. Vendimi nr.390, date 21.6.2006, i Keshillit te Ministrave, "Per krijimin dhe funksionimin e sistemit te identifikimit te kafsheve dhe regjistrimit te fermave blegtorale", shfuqizohet.

Ky vendim hyn ne fuqi pas botimit ne "Fletoren zyrtare".

KRYEMINISTRI
SALI BERISHA

MINISTRI I BUJQESISE, USHQIMIT DHE MBROJTJES SE KONSUMATORIT
JEMIN GJANA